



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 128, Datë 04.06.2018

MBI

MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT PËR NGARKESËN

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, gërma “b” të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar; nenit 26 të “*Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016” si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e Kodit të rrjeti për ngarkesën,

Dhe duke marrë në konsideratë:

- Se Shqipëria është anëtare e Sekretariati të Energjisë që nga data 01.07.2006;
- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/1388 datës 17 Gusht 2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Vendimin nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;
- Parashikimet e Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar;
- Certifikimin operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a;
- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodei do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator i sektorit të energjisë.
- Sa më sipër Bordi i ERE me vendimin nr. 101, datë 30.04.2018, filloi procedurën për miratimin e Kodit të rrjetit për ngarkesën”.
- Në vijim të vendimmarrjes sipërcituar ERE me shkresën nr. 50/25 Prot., datë 07.05.2018, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe me shkresën nr. 383 Prot., datë 11.05.2018, bëri me dije palët e interesit, për vendimin e fillimit të procedurës për këtë Kod.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë Kodin e rrjeti për ngarkesën. (bashkëlidhur në gjuhën origjinale angleze dhe në shqip).
2. "Për të njëjtat parashikime, dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator në sektorin e energjisë elektrike"
3. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palet.
4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumentit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI